



## Parashtrimi i kërkesës për çertifikatë policore jashtë vendit

Secili person që i ka mbushur 14 vjet mund të paraqes kërkesë për lëshim të një çertifikate policore.

Personat, të cilët banojnë jashtë vendit, kërkesën për lëshim të çertifikatës policore mund ta paraqesin drejtëpërdrejtë në Entin Federal të Drejtësisë. Informata më të hollësishme për këtë, si dhe formularët përkatës i gjeni në faqen zyrtare të internetit të Entit Federal të Drejtësisë në vegëzën e mëposhtme:

[https://www.bundesjustizamt.de/DE/Themen/Buergerdienste/BZR/Ausland/Antrag/FAQ\\_node.html](https://www.bundesjustizamt.de/DE/Themen/Buergerdienste/BZR/Ausland/Antrag/FAQ_node.html)

### Si duhet të veprojmë për vërtetimin e nënshkrimit tim si dhe të identitetit tim?

Vërtetimi i identitetit dhe vërtetimi i nënshkrimit duhet të bëhet zyrtarisht. Sipas përvojave të deritanishme të ambasadës, Enti Federal për Drejtësi nuk i pranon vërtetimet e identitetit dhe të nënshkrimit nga autoritetet kosovare apo nga noterët kosovarë, mirëpo kjo mund të bëhet nga ndonjë përfaqësi diplomatrike gjermane (ambasadë). Për këtë luteni ta caktoni një termin në Ambasadën Gjermane në Prishtinë në rubrikën „Çështje të tjera konsullore“. Informatat lidhur me caktimin e terminit i gjeni në faqen zyrtare të internetit të ambasadës.

Personi që paraqet kërkesën duhet të dëshmojë identitetin dhe, nëse bëhet fjalë për një përfaqësues ligjor, autorizimin e përfaqësimit.

Pas caktimit të terminit, me vete në ambasadë duhet të sillen **dokumentet** vijuese në **original**:

- ✓ Pasaporta e udhëtimit ose letërnjoftimi i parashtruesit të kërkesës
- ✓ Dëshmia/Vërtetimi i qëndrimit të zakonshëm në Kosovë

Në rastin e parashtruesve minorene, duhet domosdo në termin të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi/it ligjor/ë. Në këto raste duhet të sillen bashkë me dokumentet e cekura nën 1. dhe 2. edhe dokumentet vijuese:

- ✓ Çertifikata e lindjes së parashtruesit minorene
- ✓ Pasaporta e udhëtimit ose letërnjoftimi i përfaqësuesit/es ligjor/e

Për vërtetimin e nënshkrimit nga ana e ambasadës llogaritet tarifa në vlerë prej 56,- euro, e cila duhet të paguhet kur të paraqiteni në ambasadë në sportel. Tarifat e tjera për çertifikatën policore duhet të kryhen drejtëpërdrejtë në Entin Federal të Drejtësisë, zakonisht nëpërmjet transferit. Këto tarifa nuk mund të paguhet në ambasadë. **Si e pranojmë çertifikatën policore?**

<b>Anschrift:</b> Rr. Azem Jashanica Nr. 66, Dragodan II 10000 Pristina	<b>Post:</b> Botschaft Pristina Auswärtiges Amt 11013 Berlin	<b>Telefon:</b> +383 38 25 45 00	<b>Telefax:</b> +383 38 25 45 37	<b>E-Mail:</b> info@pris.diplo.de	<b>Internet:</b> <a href="http://www.pristina.diplo.de">www.pristina.diplo.de</a>
---	---	-------------------------------------	-------------------------------------	--------------------------------------	--

Pasiqë Ambasada vërteton identitetin Tuaj dhe vërteton nënshkrimin Tuaj në kërkesë, Ju e merrni kërkesën e plotësuar me qëllim të dërgimit të kërkesës në Entin Federal për Drejtësi. Nëqoftëse Ju sillni me vete kërkesën e plotësuar paraprakisht, atëherë kjo kërkesë nuk duhet të jetë e nënshkruar. Kërkesa duhet të nënshkruhet në ambasadë.

Termine nur nach vorheriger Vereinbarung  
unter [www.pristina.diplo.de](http://www.pristina.diplo.de)

Adresse:  
Rr. Azem Jashanica No. 66  
10000 Pristina

Telefon. +383 38 2545 00  
Fax: +383 38 2545 37  
E-Mail: [info@pris.diplo.de](mailto:info@pris.diplo.de)

Në kërkesë duhet të shënohet një adresë në të cilën duhet të dërgohet çertifikata policore. Dërgimi i çertifikatës policore në ambasadë është i mundur përjashtimisht vetëm në raste të arsyetuara në mënyrë specifike. Në këtë rast, për dërgim të metutjeshëm të çertifikatës policore, duhet të dorëzohet një zarf i parapaguar i DHL-së (mund të blihet në sportelin e DHL-së në sallën e pritjes në ambasadë). Një tërheqje personale e çertifikatës policore në ambasadë nuk është e mundur. Në rast se çertifikata duhet të dërgohet në adresë të një të autorizuari, me kërkesë duhet të dorëzohet autorizimi dhe të shënohet adresa e të autorizuarit. Çertifikata policore lëshohet vetëm në gjuhën gjermane. Nëqoftëse nevojitet një përkthim, ai duhet të sigurohet nga vetë parashtrusi i kërkesës.

**Këto të dhëna jepen në bazë të informatave, të cilat i ka pasur në dispozicion Ambasada Gjermane në Prishtinë në kohën e publikimit. Nuk merret përgjegjësi për plotësinë, saktësinë dhe aktualitetin e inform**

Termine nur nach vorheriger Vereinbarung  
unter [www.pristina.diplo.de](http://www.pristina.diplo.de)

Adresse:  
Rr. Azem Jashanica No. 66  
10000 Pristina

Telefon. +383 38 2545 00  
Fax: +383 38 2545 37  
E-Mail: [info@pris.diplo.de](mailto:info@pris.diplo.de)